



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 maj 2023
Nr. ref.:RK 2164/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI135/22

Parashtrues

Nevruz Berisha

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Pml. nr. 307/2022] të 11 gushtit
2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Nevruz Berisha, me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Ylli Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [Pml. nr. 307/2022] e 11 gushtit 2022 (në tekstin e mëtejshëm: Aktvendimi i kontestuar) të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme).
3. Aktvendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 5 shtator 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij, të garantuara me nenet: 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta], dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ].

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 9 shtator 2022, parashtruesi i kërkesës, nëpërmjet postës, e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm Gjykata).
7. Më 14 shtator 2022, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin GJR. KI135/22 caktoi gjyqtarin Safet Hoxha, gjyqtar raportues dhe me Vendimin KSH. KI135/22 caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 16 shtator 2022, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
10. Më 12 prill 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Kronologjia e dënimeve me vendime të formës së prerë

11. Më 27 nëntor 2013, Gjykata Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) me Aktgjykimin [P. nr. 421/12], e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale mundësim i prostitucionit nga neni 201 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës [në tekstin e mëtejshëm: KPRK], dhe e kishte dënuar me 1 (një) vit burgim me kusht, nëse i njëjti në afat prej 2 (dy) vitesh nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale (Aktgjykimi ishte bërë i formës së prerë, më 9 shkurt 2015).

12. Më 30 prill 2014, Gjykata Themelore, me Aktgjykimin [P. nr. 95/13], e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën penale të vjedhjes nga neni 252 i KPRK-së, dhe e kishte dënuar me gjobë në shumën prej 400 (katërqind) euro. (Aktgjykimi ishte bërë i formës së prerë më 19 maj 2014).
13. Më 11 tetor 2019, Gjykata Themelore, me Aktgjykimin [P. nr. 71/18], e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 i KPRK-së, dhe e dënoi me 3 (tre) muaj burgim me kusht, nëse i njëjti në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale (Aktgjykimi ishte bërë i formës së prerë, më 12 dhjetor 2019).
14. Më 14 dhjetor 2021, Gjykata Themelore, nëpërmjet Aktgjykimit [P. nr. 446/21], e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën penale të kanosjes nga neni 181 i KPRK-së, dhe e dënoi me gjobë në shumën prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) euro. (Aktgjykimi ishte bërë i formës së prerë më 17 janar 2022).

Fillimi i procedurave gjyqësore (Kërkesa për shlyerje nga evidenca e të dënuarave)

15. Më 15 prill 2022, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë në Gjykatën Themelore, nëpërmjet së cilës kërkoi shlyerjen nga evidenca e të dënuarve e të gjitha dënimeve të shqiptuara me aktgjykimet e formës së prerë: [P. nr. 421/12], [P. nr. 71/18], [P. nr. 95/13], [P. nr. 446/21] të Gjykatës Themelore.
16. Më 20 qershor 2022, Gjykata Themelore me Aktvendimin [PK. nr. 162/22], refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për shlyerjen e dënimeve të shqiptuara sipas Aktgjykimit [P. nr. 421/12] të 27 nëntorit 2013 dhe Aktgjykimit [P. nr. 71/18] të 11 tetorit 2019. Gjykata Themelore sa i përket dënimeve me kusht, të shqiptuara me Aktgjykimet P. nr. 421/12 dhe P. nr. 71/18, theksoi se nuk janë plotësuar kushtet e parapara ligjore në kuptim të nenit 96, paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 të KPRK-së, sepse i njëjti kishte kryer vepër tjetër penale brenda kohës sa ishte nën verifikim.
17. Më 23 qershor 2022, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit [PK. nr. 162/22] të 20 qershorit 2022 të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Parashtruesi i kërkesës nëpërmjet avokatit të tij, pretendoi se brenda afatit të verifikimit parashtruesi i kërkesës nuk ka kryer vepër tjetër penale. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës argumentoi se “si pasojë e mosveprimit të organit kompetent për shlyerje të dënimit sipas ligjit, të mbrojturit tim, kjo lëndë i është përdorur si rrethanë rënduese në shqiptimin e lartësisë së dënimit me çka i janë cenuar të drejtat e garantuara me nenin 6 të KEDNj-së, dhe neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.
18. Më 17 korrik 2022, Gjykata e Apelit me Aktvendimin [PN. nr. 684/2022], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke konsideruar se ishte e parakohshme kërkesa e tij për shlyerjen e dënimit nga evidenca e të dënuarve, ngase Aktgjykimi [P. nr. 71/18] i 11 tetorit 2019 i shkallës së parë ishte bërë i formës së prerë më 12 dhjetor 2019, dhe se periudha e rehabilitimit për këtë dënim kishte kaluar më 12 dhjetor 2021, në ndërkohë që dyshohej se në muajin korrik 2020 i njëjti ka kryer vepër tjetër penale.

Mjeti i jashtëzakonshëm juridik

19. Më 28 korrik 2022, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale dhe materiale.

Parashtruesi i kërkesës pretendonte që Aktvendimi [PN. nr. 684/2022] i Gjykatës së Apelit është tërësisht i njëjtë me Aktvendimin [PK. nr. 162/22] e Gjykatës Themelore. Sipas tij, Gjykata e Apelit nuk i ka trajtuar fare pretendimet sipas ankesës, por vetëm i ka përshkruar qëndrimet e Gjykatës Themelore. Parashtruesi i kërkesës pretendoi që Gjykata e Apelit nuk i ka arsyetuar pretendimet kryesore të ankesës duke mos dhënë asnjë konstatim në lidhje me ato.

20. Më 11 gusht 2022, Gjykata Supreme nëpërmjet Aktvendimit [Pml. nr. 307/2022], hodhi poshtë si të papranueshme kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, me arsyetimin se në rrethana të këtilla nuk kemi të bëjmë me vendim të formës së prerë, por me kërkesë për shlyerje nga evidenca e të dënuarave, si rrjedhojë nuk është përmbushur kushti i lejueshmërisë së ushtrimit të mjetit të jashtëzakonshëm juridik.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon që akti i kontestuar shkel të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet: 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të Konventës.
22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit me Aktvendimin [PN. nr. 684/2022] të 20 qershorit 2022, ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke mos arsyetuar fare pretendimin kryesor ankimor të tij, se përse nuk është dashur të fshihet *ex lege* lënda [PKR. nr. 421/12], sipas nenit 96 të KPRK-së, përkatësisht paragrafi 2, nënparagrafi 2.2. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit është përsëritje e arsyetimit të aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, pa asnjë ndryshim fare. Parashtruesi i kërkesës, në këtë kuptim, mëton se Gjykata e Apelit, duke mos arsyetuar aktvendimin e saj, ka shkelur rëndë parimin e ligjshmërisë, sepse Aktgjykimi [PKR. nr. 421/12] i formës së prerë i gjykatës së shkallës së parë është përdorur si rrethanë rënduese në një procedurë tjetër penale, edhe pse kanë pushuar pasojat ligjore, ashtu që e njëjta ka ndodhur vetëm për fajin e gjykatës pasi që nuk është shlyer në afat ligjor, siç është dashur nga gjykata.
23. Sipas parashtruesit të kërkesës, *“me mos mundësimin e rehabilitimit ligjor për Aktgjykimin PKR. nr. 421/12, i cili pas kalimit të afatit të paraparë ligjor ka qenë dashur të fshihet automatikisht nga gjykata -ex lege, parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht, e drejta e gjyqimit në afat të arsyeshëm, duke mos arsyetuar fare pretendimet ankimore Gjykata e Apelit parashtruesit të kërkesës i ka cenuar të drejtën në një vendim të arsyetuar”*.
24. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon që Aktvendimi [Pml. nr. 307/2022] i Gjykatës Supreme, që hodhi si të papranueshëm kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga ai, shkeli të drejtat e tij kushtetuese të garantuara nga neni 32 dhe 54 i Kushtetutës.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 30

[Të Drejtat e të Akuzuarit]

Çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:

- (1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër saj/tij;
- (2) të njoftohet për të drejtat e tij/saj sipas ligjit;
- (3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet; (4) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi;
- (5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas;
- (6) të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet.

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
 3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
 4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
 5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.
- [...]

Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 54

[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt gjyqësor)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohe nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga

gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 96

[Rehabilitimi ligjor]

1. *Me rehabilitimin ligjor dënimi shlyhet nga evidenca e personit të dënuar, siç parashihet në paragrafin 2. të këtij neni dhe personi i tillë nuk konsiderohet i dënuar.*

2. *Dënimi shlyhet nga evidenca e personit të dënuar pas skadimit të periudhave kohore vijuese, duke vepruar sipas ligjit, nëse personi i dënuar brenda afateve vijuese nuk kryen ndonjë vepër të re penale:*

2.1. *një (1) vit nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit në rastin e lirimit nga dënimi;*

2.2. *një (1) vit nga dita e skadimit të periudhës së verifikimit në rastin e dënimit me kusht;*

[...]

Neni 97

[Rehabilitimi gjyqësor]

Gjykata, me kërkesën e personit të dënuar, mund të vendosë që dënimi t'i shlyhet nga evidenca e personit të dënuar dhe ai person konsiderohet i padënuar nëse ka kaluar gjysma e afatit përkatës të paraparë me paragrafin 2. të nenit 96 të këtij Kodi dhe nëse personi i dënuar gjatë kësaj kohe nuk ka kryer vepër të re penale. Me rastin e vendosjes për shlyerjen e dënimit të parashkruar ose përfunduar me falje ose me ndryshim të Kodit Penal, gjykata merr parasysht sjelljen e personit të dënuar pas mbajtjes së dënimit, natyrën e veprës penale dhe rrethanat e tjera të cilat mund të jenë të rëndësishme për vlerësimin e përshtatshmërisë së shlyerjes së dënimit.

KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE

Neni 520

[Shlyerja e dënimit]

1. *Kur ligji parasheh shlyerjen e dënimit sipas nenit 96 të Kodit Penal, organi publik kompetent për çështje gjyqësore sipas detyrës zyrtare merr aktvendimin për shlyerjen e dënimit.*

2. *Para marrjes së aktvendimit mbi shlyerjen e dënimit bëhen gjurmime të nevojshme, veçanërisht në mbledhjen e të dhënave të cilat tregojnë nëse i dënuari është dënuar sërish për ndonjë vepër të re penale të kryer para kalimit të afatit të paraparë për shlyerjen e dënimit.*

Neni 521

[Procedura për shlyerjen e dënimit në rastet kur organi administrativ nuk vepron]

1. *Kur organi publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore nuk merr aktvendim mbi shlyerjen e dënimit sipas detyrës zyrtare, personi i dënuar mund të kërkojë të konstatohet se shlyerja e dënimit është bërë në bazë të ligjit.*

2. *Organi publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore nxjerr aktvendim për shlyerje të dënimit brenda tridhjetë (30) ditëve nga paraqitja e kërkesës së personit të dënuar.*

3. *Kërkesa e tillë trajtohet në përputhje me Ligjin përkatës për Procedurën Administrative.*

Neni 522

[Shlyerja e dënimeve alternative]

Kur dënimi alternativ nuk revokohet pas një (1) viti nga dita e pushimit të kohës së verifikimit, subjekti kompetent publik në lëmin e çështjeve gjyqësore, sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë merr aktvendim me të cilin e shlyen dënimin. Këtu aplikohet Ligji përkatës për Procedurën Administrative.

Neni 523

[Procedura për shlyerjen e dënimit në bazë të vendimit gjyqësor]

- 1. Procedura për shlyerjen e dënimit në bazë të vendimit gjyqësor nga neni 97 i Kodit Penal fillohet me kërkesë të të dënuarit.*
- 2. Kërkesa i paraqitet gjykatës e cila ka vendosur në shkallë të parë.*
- 3. Gjyqtarit të cilit i caktohet çështja, së pari konstaton nëse ka kaluar afati i paraparë i nevojshëm ligjor, pastaj bën gjurmime të nevojshme, vërteton faktet të cilat i pohon kërkuesi dhe mbledh prova për të gjitha rrethanat e rëndësishme për vendim.*
- 4. Gjykata për sjelljet e kërkuesit mund të kërkojë raport nga policia në territorin e të cilit ai ka banuar pas mbajtjes së dënimit, ndërsa raport të tillë mund të kërkojë edhe nga administrata e institucionit ku i dënuari ka mbajtur dënimin.*
- 5. Pas kryerjes së gjurmimeve dhe pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, kur procedura zbatohet sipas kërkesës së tij, gjyqtari ia dërgon lëndën me propozim të arsyetuar kolegjit të gjykatës e cila e ka gjykuar çështjen në shkallë të parë.*
- 6. Kërkuesi ose prokurori i shtetit mund të ushtrojë ankesë ndaj vendimit të gjykatës për shlyerjen e dënimit.*
- 7. Kur gjykata refuzon kërkesën për shkak se i dënuari me sjelljen e tij nuk e ka arsyetuar shlyerjen e dënimit, i dënuari përsëri mund të paraqesë kërkesë pasi të kalojnë dy (2) vite nga dita kur aktvendimi mbi refuzimin e kërkesës ka marrë formën e prerë.*

Neni 524

Efekti i shlyerjes nga evidenca e dënimeve

Dënimi i shlyer nuk shënohet në certifikatën e lëshuar të bazuar në evidencën e dënimeve për realizimin e të drejtave të individëve.

Pranueshmëria e kërkesës

- 25. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.*
- 26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:*

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

27. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen më tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”.

28. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ai konteston kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Pml. nr. 307/2022], të 11 gushtit 2022 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parasheh neni 49 i Ligjit.
29. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht me nënrregullin (2), të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

(2) “Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk e mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.
[...]

30. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”;

(iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GjEDNj-së Trofimchuk kundër Ukrainës, nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu Baillard kundër Francës, nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNj-së, Kemmache kundër Francës, nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), Juta Mentzen kundër Lituanisë, nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe Trofimchuk kundër Ukrainës, Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii).

31. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon që gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat kushtetuese të tij të garantuara me nenet: 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të KEDNj-së.
32. Megjithatë, Gjykata nga shkresat e lëndës vëren se pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me të “drejtën për vendim të arsyetuar”, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së.
33. Në këtë kontekst, Gjykata do t'i shqyrtojë dhe analizojë këto pretendime, në pajtueshmëri me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GjEDNj), në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, gjykatat e juridiksionit të rregullt dhe Gjykata Kushtetuese janë të detyruara të interpretojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

i. Vlerësimi i Gjykatës, përkritazi me pretendimet për shkeljen e të drejtës për “vendim të arsyetuar”

a) Parimet e përgjithshme

34. Në parim, praktika gjyqësore e GjEDNj-së dhe ajo e Gjykatës theksojnë se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe se gjykatat duhet “të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ato bazuan vendimin e tyre”. Megjithatë, ky detyrim i gjykatave nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të atij rasti. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih rastin e Gjykatës KI07/18, parashtrues “Çeliku Rollers” sh.p.k, Aktgjykim i 18 dhjetorit 2019, paragrafi 100 dhe 101).
35. Përkundër faktit që gjykatat e rregullta kanë një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe vendosjes për pranueshmërinë e dëshmimeve, ajo është

- e detyruar të justifikojë veprimet e saj, duke arsyetuar të gjitha vendimet (shih rastet e GjEDNj-së, [Suominen kundër Finlandës](#), nr. 37801/97, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 36; si dhe rastin [Carmel Saliba kundër Maltës](#), nr. 24221/13, Aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73).
36. Gjykata më e ulët ose autoriteti shtetëror, nga ana tjetër, duhet të japin arsye dhe arsyetime të tilla të cilat do t'ua mundësojnë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive të drejtën ekzistuese të ankesës (shih rastin e GjEDNj-së, [Hirvisaari kundër Finlandës](#), nr. 49684/99, Aktgjykim i 25 dhjetorit 2001, paragrafi 30). Neni 6, paragrafi 1 i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument (shih, rastet e GjEDNj-se, [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 29 janarit 1999, paragrafi 26; [Perez kundër Francës](#), nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81).
 37. Përveç kësaj, kur refuzon një ankesë, Gjykata e Apelit, në parim, thjesht mund të pranojë arsyetimin e vendimit të dhënë nga gjykata më e ulët (shih rastin e GjEDNj-së, [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, cituar me lart, paragrafi 26; në kundërshtim me këtë shih [Tatishvili kundër Rosisë](#), nr. 1509/02, Aktgjykim i 9 korrikut 2007, paragrafi 62). Megjithatë, koncepti i procedurës së drejtë nënkupton që gjykata vendase që ka dhënë një shpjegim të ngushtë për vendimet e saj, qoftë duke përsëritur arsyetimet e dhëna më parë nga një gjykatë më e ulët ose në ndonjë mënyrë tjetër, në fakt merrej me çështje të rëndësishme brenda juridiksionit të saj, që do të thotë se nuk i pranoi thjesht dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët (shih rastin e GjEDNj-së, [Helle kundër Finlandës](#), nr. (157/1996/776/977), Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60). Kjo kërkesë është aq më e rëndësishme nëse pala në kontest nuk ka pasur mundësi t'i paraqesë argumentet e saj gojarisht në procedurën para gjykatës vendase.
 38. Megjithatë, gjykatat e apelit (në shkallën e dytë) të cilat kanë juridiksion për të hedhur poshtë ankesat e pabazuara dhe për të zgjidhur çështjet faktike dhe juridike në procedurën kontestimore, janë të obliguara të arsyetojnë se përse refuzuan të vendosin për ankesën (shih rastin e GjEDNj-se, [Hansen kundër Norvegjisë](#), nr. 15319/09, Aktgjykim i 2 janarit 2015, paragrafët 77-83).
 39. Neni 6, paragrafi 1, nuk kërkon që Gjykata Supreme të japë një arsyetim më të detajuar kur ajo thjesht zbaton një dispozitë të caktuar ligjore lidhur me bazën ligjore për refuzimin e ankesës, sepse ajo ankesë nuk ka një perspektivë për sukses (shih, rastet e GjEDNj-së, [Burg dhe të tjerët kundër Francës](#), nr. 34763/02; vendim i 28 janarit 2003; [Gorou kundër Greqisë](#) (nr. 2), nr. 12686/03, vendim i 20 marsit 2009, paragrafi 41; shih rastin e Gjykatës [KI106/22](#), me parashtrues [Driton Fetahu](#), Aktvendim i 8 shkurtit 2023, paragrafi 45-56).
 40. Një funksion tjetër i vendimit të arsyetuar është që t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i ofron mundësinë palës për t'u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e rishikimit të vendimit nga një organ ankimor. Vetëm duke lëshuar vendim të arsyetuar, mund të ketë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë. (shih, GJEDNj, rastin [Tatishvili kundër Rosisëër Rosisë](#), cituar më lart, paragrafi 58).
 41. Veç kësaj, e drejta e marrjes së vendimit gjyqësor në harmoni me ligjin, përfshin obligimin e gjykatave të ofrojnë arsye për aktvendimet e tyre me baza të arsyeshme në nivel procedural dhe material. Sigurimi i arsyeve kërkon shpjegime me arsye bindëse dhe të ndërtuara mirë për vendimin e marrë në çdo rast individual, i cili duhet të përfshijë që të dyja: kriteret ligjore dhe elementet faktike në mbështetje të vendimit.

42. Prandaj, arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet gjetjeve të meritave dhe reflektimit, kur t'i shqyrtojë provat e propozuara nga një anë dhe konkluzionet ligjore nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do ta shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, nëse arsyetimi i dhënë dështon të përmbajë fakte të vërtetuara dhe dispozita ligjore si dhe marrëdhënien logjike ndërmjet tyre (shih rastin e Gjykatës [KI72/12](#), me parashtrues Veton Berisha dhe Ilfete Haziri, Aktgjykim i 5 dhjetorit 2012, par. 53-61).
43. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata nga rasti në rast, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Masa deri në të cilën aplikohet detyra për ta arsyetuar vendimin mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit gjyqësor dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit (shih, GJEDNj rastet, *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykimi i 27 shtatorit 2001, paragrafi 30).
- b) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret
44. Referuar pretendimeve të ngritura në kërkesë, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës thekson se *“me mos mundësimin e rehabilitimit ligjor për Aktgjykimin PKR.nr.421/12, i cili pas kalimit të afatit të paraparë ligjor ka qenë dashur të fshihet automatikisht nga gjykata -ex lege, parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht, e drejta e gjykimit në afat të arsyeshëm, duke mos arsyetuar fare pretendimet ankimore Gjykata e Apelit parashtruesit të kërkesës i ka cenuar të drejtën në një vendim të arsyetuar”*.
45. Në shqyrtimin e pretendimit kryesor të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht i referohet pjesëve relevante të Aktvendimit [PK. nr. 162/22], të 20 qershorit 2022 të Gjykatës Themelore, e cila arsyetoi: *“Kolegji gjeti se sa i përket dënimeve me kusht, të shqiptuara sipas aktgjykimeve P.nr.421/12 dhe P.nr. 71/18, nuk janë plotësuar kushtet e parapara ligjore në kuptim të nenit 96, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 të KPRK-së, për shlyerje nga evidenca e të dënuarve, ngase qartë në dispozitën e lartcekur theksohet se dënimi shlyhet nga evidenca e personit të dënuar një (1) vit nga dita e skadimit të periudhës së verifikimit në rastin e dënimit me kusht, nëse personi i dënuar brenda këtij afati nuk kryen ndonjë veprë të re penale, e që nga shkresat e lëndës pas gjurmimeve të nevojshme, ka rezultuar se i dënuari Nevruz Berisha, pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë është duke u gjykuar për veprën penale mundësim ose detyrim në prostitucion nga neni 234, par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas lëndës penale P.nr.195/21, ku me aktgjykimin e datës 14.04.2022 i njëjti është shpallur fajtor dhe i është shqiptar dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëmbëdhjetë (11) muaj, i cili aktgjykim gjendet në Gjykatën e Apelit për të vendosur sipas ankesës së palëve ndaj aktgjykimit, ...”*.
46. Në këtë kontekst, Gjykata Themelore shtoi se, *“... se vepra penale për të cilën është gjykuar sipas Aktgjykimit P.nr.95/21, e ka kryer para kalimit të afatit të paraparë ligjor për shlyerjen e dënimit me kusht të shqiptuar sipas Aktgjykimit P.nr.71/18, pasi që periudha e rehabilitimit ligjor për këtë dënim ka kaluar me datën 12.12.2021, ndërsa veprën penale mundësim ose detyrim në prostitucion nga neni 234.par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dyshohet se e ka kryer në muajin korrik 2020, andaj kolegji në rastin konkret, kërkesën e të dënuarit për shlyerjen e dënimeve me kusht e ka refuzuar si të pabazuar, pasi që në rastet kur të njëjtit person i janë shqiptar shumë dënime, mund të shlyhen dënimet vetëm në të njëjtën kohë dhe atë nëse janë plotësuar kushtet për shlyerjen e secilit prej tyre, duke pasur parasysh se në rastin konkret edhe pse tani ka kaluar koha e paraparë me nenin 96, par.2 nënpar. 2.2 të KPRK-së për*

shlyerjen e dënimeve me kusht të shqiptuar sipas aktgjykimeve P.nr.421/12 dhe P.nr.71/18, nuk është plotësuar kushti tjetër që i dënuari brenda kësaj kohe të mos kryej ndonjë vepër tjetër penale. (...).

47. Tutje, Gjykata vëren se Gjykata Themelore, përkitazi me dënimet me gjobë të shqiptuara ndaj parashtruesit të kërkesës, arsyetoi: *“Sa i përket dënimeve me gjobë të shqiptuara, sipas aktgjykimeve P.nr.95/21 dhe P.nr.446/21, me Kodin e ri Penal nr.06/L-074, i cili ka hyrë në fuqi me datë 14.04.2019, në nenin 93, par.2 të KPRK-së, është paraparë se pasojat juridike të dënimit nuk krijohen kur kryesit i shqiptohet gjoba ose vërejtja gjyqësore dhe se për këto lloje të dënimeve nuk parashihet rehabilitimi ligjor në nenin 96 të KPRK-së, andaj, për këtë dënim nuk do të vendoset me vendim gjyqësor, por shlyerja nga evidenca do të bëhet sipas detyrës zyrtare nga organi që e mbanë evidencën, ndërsa për të dënuarin, me kërkesën e tij nga gjykata do të lëshohet vërtetim i cili do t'i shërbej për shlyerje të këtyre rasteve nga evidenca që e mbanë Policia e Kosovës, në të kundërtën kur të plotësohen kushtet për shlyerjen e dënimeve me kusht, me kërkesën e të dënuarit, gjykata me të njëjtin vendim do t'i shlyej edhe dënimet me gjobë”.*
48. Gjykata, duke iu referuar tutje pretendimeve të parashtruesit të kërkesës se Gjykata e Apelit, vetëm kishte përsëritur arsyetimin e dhënë nga Gjykata Themelore, vëren se në Aktvendimin e saj [PN. nr. 684/2022] të 17 korrikut 2022, Gjykata e Apelit arsyetoi: *“Duke marrë parasysh gjendjen e vërtetuar, kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se është e parakohshme kërkesa e të dënuarit për shlyerjen e dënimit nga evidenca e të dënuarve, (...) ngase aktgjykimi P.nr. 71/18 i datës 11.10.2019, i formës së prerë nga data 12.12.2019, me të cilin i njëjti është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar dënim me kusht në kohëzgjatje prej një viti, pasi që periudha e rehabilitimit ligjor për këtë dënim ka kaluar me datën 12.12.2021, sikurse që parasheh dispozita ligjore e nenit 96, par. 2 nën par. 2.2 të KPRK-së, ndërsa veprën penale mundësim ose detyrim në prostitucion nga neni 234.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dyshohet se e ka kryer në muajin korrik 2020, sikurse që shihet i njëjti ekziston dyshimi i bazuar mirë se veprën penale e ka kryer brenda periudhës së verifikimit e që në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 96 par. 2 të KPRK-së parashihet se: “Dënimi shlyhet nga evidenca e personit të dënuar pas skadimit të periudhave kohore vijuese, duke vepruar sipas ligjit, nëse personi i dënuar brenda afateve vijuese nuk kryen ndonjë vepër të re penale”, e që në rastin konkret i bie se i njëjti ka kryer vepër të re penale brenda afatit të verifikimit, prandaj konkludimi i gjykatës së shkallës së parë se kërkesa e të dënuarit për shlyerje nga evidenca e të ndëshkuarve është e parakohshme, është i drejtë dhe i bazuar në ligj, konkludim të cilin në tërësi e mbështet edhe kjo gjykatë”.*
49. Në këtë vazhdë, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër aktvendimeve të mësipërme të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit. Megjithatë, Gjykata Supreme, nuk u lëshua në meritat e çështjes, duke arsyetuar se: *“Sipas dispozitës së nenit 432, par. 1 të KPRK-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë. Ndërkaq, sipas dispozitës së nenit 432, par.4 të KPRK-së, gjatë procedurës penale e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin ose vazhdimin e paraburgimit”. “Në rastin konkret, nuk është fjala për vendimin që është marrë gjatë procedurës penale e që ka përfunduar me formë të prerë, por për procedurën, shlyerjen e dënimeve nga evidenca e të dënuarve, andaj, nuk është përmbushur kushti i lartcekur për lejueshmërinë e paraqitjes së këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik”.*

50. Gjykata, sa më sipër, vlerëson se të gjitha pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës, të cilat i kishte ngritur me kërkesë pranë Gjykatës Themelore dhe nëpërmjet ankesës në Gjykatën e Apelit, ishin trajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të detajuar nga të njëjtat. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se përfundimet e Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit janë arritur pas një shqyrtimi të hollësishëm të të gjitha argumenteve të parashtruara nga parashtruesi i kërkesës. Si rrjedhojë, Gjykata vlerëson se arsyetimi i dhënë nga ato gjykata është brenda standardeve të një gjykimi të drejtë, dhe të parimeve të përcaktuara nga GjEDNj-së dhe Gjykata, përkitazi me të drejtën për vendim të arsyetuar.
51. Për më tepër, jurisprudenca e GJEDNj-së përcakton se kur kemi të bëjmë me ligjshmërinë e vendimeve, Gjykata e Apelit, në parim, thjesht mund të pranojë arsyetimin e vendimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë dhe kjo në vetvete nuk është në kundërshtim me kërkesat e nenit 6 të KEDNj-së, (shih, [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, cituar më lart, paragrafi 26). Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se fakti që përfundimet e Gjykatës Themelore janë pranuar edhe nga Gjykata e Apelit si të drejta dhe të ligjshme, nuk nënkupton se është dashur ndryshe të duket përmbajtja e arsyetimi të vendimit të saj. Për më tepër, kjo e fundit në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ka arsyetuar se nuk kemi të bëjmë me shkelje të ligjit në rastin konkret.
52. Gjykata përsërit se neni 6 i KEDNj-së nuk kërkon që gjykata më e lartë të japë një arsyetim më të detajuar kur ajo thjesht zbaton një dispozitë të caktuar ligjore lidhur me bazën ligjore për refuzimin e ankesës, sepse ajo ankesë nuk ka një perspektivë për sukses (shih rastet e GjEDNj-së, [Burg dhe të tjerët kundër Francës](#), nr. 34763/02; vendim i 28 janarit 2003; [Gorou kundër Greqisë](#) (nr. 2), nr. 12686/03, vendim i 20 marsit 2009, paragrafi 41; shih rastin e Gjykatës [KI106/22](#), me parashtrues *Driton Fetahu*, Aktvendim i 8 shkurtit 2023, paragrafi 45-56).
53. Sa i përket pretendimeve në lidhje me aktvendimin e kontestuar, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme, kishte dhënë arsye të bazuara në ligj, duke shpjeguar se përse në rastin konkret është dashur të hedhet poshtë si e palejuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Gjykata Supreme, tutje arsyetoi se në këtë rast konkret nuk kemi të bëjmë me “vendim të formës së prerë”, por me “kërkesë për shlyerje nga evidenca e të dënuarave”, andaj nuk është plotësuar kushti i lejueshmërisë së ushtrimit të këtij mjetit të jashtëzakonshëm juridik. Në dritën e kësaj, Gjykata arrin në përfundimin se aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, përmban arsyetim të nevojshëm sepse në mënyrë të qartë tregon shkaqet e moslejimit të ushtrimit të këtij mjetit juridik.
54. Gjykata thekson se neni 6 i KEDNj-së, në një proces gjyqësor, nuk i garanton askujt rezultat të favorshëm, sepse njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës [KI118/17](#), *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, paragrafi 36; dhe [KI142/15](#), parashtrues *Habib Makiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 1 nëntorit 2016, paragrafi 43, dhe [KI125/21](#) parashtrues *Armend Osaj*, Aktvendimi i 11 majit 2022, paragrafi 73).
55. Fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurës dhe përmbajtjen e vendimeve të gjykatave të rregullta, nuk është i mjaftueshëm për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih rastin e Gjykatës, [KI136/14](#), parashtrues *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).

56. Thënë këtë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, i përkasin kategorisë së tretë (iii), të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj të njëjtat në baza kushtetuese duhet shpallur qartazi të pabazuara.

ii. Përkitazi me pretendimet e tjera

57. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, përveç pretendimeve për shkelje të së drejtës për vendim të arsyetuar, pretendon edhe shkelje të neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës. Megjithatë, në këtë kontekst i njëjti vetëm përmend këto nene, por nuk elboren dhe shtjellon më tej si dhe pse ka ardhur deri te shkelja e tyre nga ana e Gjykatës Supreme. Siç është shprehur edhe në rastet e tjera, Gjykata përsërit qëndrimin e saj se vetëm përmendja dhe citimi i neneve të Kushtetutës apo instrumenteve të tjera ndërkombëtare, nuk mjafton për të ngritur pretendime për shkelje të të drejtave kushtetuese. Kur pretendon për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë, parashtruesi duhet të paraqesë dëshmi dhe argumente bindëse, për të dëshmuar shkeljet e supozuara (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: [KI175/20](#), me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; [KI166/20](#) parashtrues *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2020, paragrafi 52; [KI04/21](#), me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39, dhe [KI64/22](#), parashtrues *Vatani Shpk*, Aktvendim i 29 shtatorit 2022, paragrafi 77).
58. Thënë këtë, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e neneve të lartcekura, në baza kushtetuese duhet deklaruar qartazi të pabazuara.

Përfundime

59. Si përmbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se: (I) pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj, përkitazi me mohimin e të drejtës për vendim të arsyetuar, i takojnë kategorisë së tretë (iii) të pretendimeve të *pambështetura ose të paarsyetuara*, andaj të njëjtat në baza kushtetuese i deklaroon qartazi të pabazuara; (II) pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 32 dhe 54 të Kushtetutës, i takojnë kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj në baza kushtetuese të njëjtat po ashtu i deklaroon qartazi të pabazuara.
60. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, në pajtueshmëri me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, duhet deklaruar e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 12 prill 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- III. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani